



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

RAPORTI VJETOR I PUNËS

VITI 2024

Bulevardi Zogu I, Nd.9, H.4, Ap.7, 1016 Tiranë; Tel: +355042227131;
e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

- *Kuadri legjislativ i së drejtës së lirisë së fesë e besimit në Shqipëri.*
- *Kuadri institucional fetar për vitin 2024.*
- *Kuadri ligjor mbi të cilin bazohet veprimtaria e KSHK dhe organizimi i tij.*

KAPITULLI II

- *Drejtimit kryesore për realizimin e objektivave gjatë vitit 2024.*

KAPITULLI III

- *Buxheti për vitin 2024:*
 - *zërat ekonomikë dhe realizimet e tyre.*
 - *prokurimet.*

KONKLUSIONE

AKRONIME

- **BF** – *Bashkësi Fetare*
- **KSHK** – *Komiteti Shtetëror për Kultet*
- **KMSH** – *Komuniteti Mysliman i Shqipërisë*
- **KOASH** – *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë*
- **KKSH** – *Kisha Katolike në Shqipëri*
- **KBB** – *Kryegjyshata Botërore Bektashiane*
- **VUSH** – *Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë*
- **ASHK** – *Agjencia Shtetërore e Kadastrës*
- **MEPJ** – *Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme*
- **MSHMS** – *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*
- **MASR** – *Ministria e Arsimit dhe Sportit*
- **OJF** – *Organizata Jofitimprurëse*

HYRJE

Komiteti Shtetëror për Kultet është institucion qendror, në varësi të Kryeministrit. KSHK ushtron veprimtarinë e tij në bazë të VKM-së Nr. 459, datë 23.09.1999, i ndryshuar dhe i nënshtrohet të drejtës kushtetuese të lirisë së fesë e besimit, në nenet 10 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku njihet barazia e bashkësive fetare dhe ku Shteti dhe Bashkësitë Fetare (BF) respektojnë në mënyrë të ndërsjellë pavarësinë e njëri - tjetrit.

KSHK, në kryerjen e detyrave të tij, mbështetet edhe në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, në këtë fushë.

Në këtë kuadër, mbarëvajtja e institucionit bëhet e mundur në sajë të bashkëpunimit të rëndësishëm e shumëpalësh me BF, me OJF-të me karakter fetar dhe me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor.

Gjatë vitit 2024, veprimtaria e KSHK-së është mbështetur dhe ka zbatuar rigorozisht legjislacionin në fuqi dhe Planin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, ligjin 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, në të cilat janë të përcaktuara qartë objektivat, drejtimet, mënyrat e realizimit të tyre, shoqëruar me shpenzimet përkatëse të alokuara.

Në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtës së fesë apo besimit, KSHK ka vijuar punën e tij në fuqizimin e klimës dhe respektit për besimin fetar në vend, si faktor themelor në përforcimin e bashkëjetesës fetare dhe si vlerësim për kontributin shoqëror, arsimor e shëndetësor të bashkësive dhe organizatave fetare që zhvillojnë aktivitetin e tyre në territorin shqiptar. Për rrjedhojë, KSHK i ka kushtuar një vëmendje të veçantë sigurimit të së drejtës së besimit, duke i konsideruar fetë si kontribues dhe partnerë të fuqishëm në përhapjen e vlerave morale dhe zgjidhjen e problematikave sociale, duke u angazhuar totalisht për ngritjen e nivelit koordinues mes shtetit dhe feve.

Rezultatet e arritura në këtë drejtim, janë bërë objekt i vlerësimit edhe nga ana e organizmave ndërkombëtare të interesuar në këtë drejtim, ku evidentohet roli pozitiv dhe inkurajues i shtetit shqiptar për ushtrimin dhe mbrojtjen e lirisë së fesë apo besimit, apo mungesa e rasteve të diskriminimit për shkak të përkatësisë fetare apo e problemeve sistematike dhe thelbësore në këtë fushë.

KAPITULLI I

Kuadri legjislativ i së drejtës së lirisë së fesë e besimit në Shqipëri

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me nenet 10 dhe 24, garanton të drejtën e lirisë së besimit dhe siguron ndarjen dhe pavarësinë e shtetit nga feja. Në to shprehimisht thuhet:

Neni 10: 1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. 2. Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. 3. Shteti nje barazinë e bashkësive fetare. 4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjelltë pavarësinë e njëritjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. 5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend. 6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

Neni 24: 1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. 2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve. 3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

Njëkohësisht, ligjet mbështetëse në këtë fushë, rrisin efektivitetin dhe bëhen provë e fuqishme e zbatimit në jetë të këtyre të drejtave. Këtë e dëshmon panorama e larmishme fetare e vendit tonë, ku ndërthuren fe dhe tradita fetare të ndryshme, dhe ku, krahas pesë komuniteteve kryesore fetare, të cilat kanë ratifikuar marrëveshje reciproke me Qeverinë Shqiptare, ushtrojnë misionin e tyre, edhe besime të tjera, të përfaqësuara nga dhjetëra fondacione, organizata apo shoqata.

E drejta e lirisë apo besimit fetar, rrjedh gjithashtu, nga angazhimet në nivel ndërkombëtar që shteti shqiptar ka pranuar dhe zbatuar. Shqipëria ka ratifikuar 9 traktate ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtës së fesë apo besimit, krahas pjesëmarrjes dhe rolit të saj aktiv në Këshillin Evropian.

Rezultatet e arritura në këtë drejtim, janë bërë objekt i vlerësimit nga ana e organizmave ndërkombëtare të interesuar në këtë fushë. Këtë e dëshmojnë deklaratat nga takimet dhe raportet e ndryshme të përfaqësuesve ndërkombëtarë, ku evidencohet roli pozitiv dhe inkurajues i shtetit shqiptar për ushtrimin dhe mbrojtjen e lirisë së fesë apo besimit, dëshmi e të cilës është mungesa e rasteve të denoncuara të diskriminimit për shkak të përkatësisë fetare apo e problemeve sistematike dhe thelbësore në këtë fushë, edhe gjatë vitit 2024.

Aktualisht, përveç 5 bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Qeverinë shqiptare, ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe shumë besime të tjera, që veprojnë në formën e shoqatave/organizmave me karakter humanitaro-fetar. OJF-të udhëhiqen nga legjislacioni kryesor përkatës ekzistues, i cili përfshin, por nuk kufizohet, me Kushtetutën Shqiptare, të ndryshuar, Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar dhe Ligji nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”. OJF-të

e huaja ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri në përputhje me Kushtetutën shqiptare dhe legjislacionin e organizatave jofitimprurëse.

Kuadri institucional fetar për vitin 2024

Bashkësitë fetare si vijon: 1) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, 3) Kisha Katolike në Shqipëri, 4) Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe 5) Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, kanë nënshkruar marrëveshjeve për marrëdhënie të ndërsjella me Këshillin e Ministrave. Këto të fundit që janë ratifikuar në parlament me ligjet përkatëse: Ligji nr. 8902, datë 23/05/2002, Ligji nr. 10056, datë 22/01/2009, Ligji nr. 10057, datë 22/01/2009, Ligji nr. 10058, datë 22/01/2009, ligji nr. 10394, datë 10/03/2011, vendosin kornizën ligjore mbi të cilën bazohen raportet mes shtetit dhe bashkësive fetare. Njëkohësisht ligjet e mësipërme, u krijojnë komuniteteve fetare, kushtet që të ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre të besimit, edukimit fetar, aktiviteteve, shërbesave etj. Katër prej këtyre bashkësive, që prej vitit 2009 asistohen financiarisht nga shteti shqiptar për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve laikë të administratës dhe arsimit, në zbatim të ligjit Nr. 10140, datë 15.05.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”. Shuma e akorduar nga Këshilli i Ministrave ishte në masën prej 113.000.000 lekësh, e shpërndarë me VKM-në nr. 266, datë 02.05.2024 “Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e shtetit 2024, për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”.

Krahas bashkësive fetare të sipërpërmendura, në Republikën e Shqipërisë ushtrojnë të drejtën kushtetuese të lirisë së fesë, besime të tjera, siç janë: Baha'i, Dëshmitarët e Jehovait, Kisha e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, Xhemati Ahmaddya, e shumë të tjerë, që veprojnë nëpërmjet shoqatave/ organizatave/ fondacioneve me karakter humanitaro – fetar, të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, në zbatim të ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”.

Kuadri ligjor mbi të cilin bazohet veprimtaria e KSHK dhe organizimi i tij

Komiteti Shtetëror për Kultet u krijua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 459, datë 23.09.1999 , “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet”, si vazhde e Sekretariatit mbi fenë dhe shprehje e qartë e ndjeshmërisë që qeveria shqiptare tregon për rolin e fesë në shoqëri. Vendimi i sipërpërmendur u pasua me ndryshime në varësinë dhe organikën e KSHK, si vijon: me VKM-në Nr. 128, datë 11.03.2004, me VKM-në Nr. 666, datë 26.10.2005, me VKM-në Nr. 777, datë 14.12.2005, me VKM-në Nr. 344, datë 07.06.2006, me VKM-në 1029, datë 27.11.2003 dhe me VKM-në Nr. 602, datë

10.09.2014, me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 229, datë 15.12.2023 “Për miratimin e organikës së Komitetit Shtetëror për Kultet”, pa ndryshuar natyrën e punës së tij, si hallkë rregullatore mes Shtetit dhe feve.

Komiteti Shtetëror për Kultet ka si funksion kryesor: *“për të ndihmuar në krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare, që kanë objekt dhe ndjekin qëllime besimi dhe ndërgjegje, sipas ligjit në Republikën e Shqipërisë”*.

Ky institucion synon dhe ka si përparësi të veprimtarisë së vet, punën për:

- Zbatimin e detyrimeve kushtetuese;
- Plotësimin e kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet e shtetit me fenë;
- Zbutjen dhe shuarjen e konflikteve që mund të çënojnë harmoninë ndërfaqetare në vend.


Përgjegjësitë kryesore të KSHK mund të përmbliidhen si vijon:

- Bashkërendimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare, shoqatat, fondacionet fetare ose humanitare-fetare;
- Garantimin e lirisë së besimit dhe për zhvillimin, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe tolerancën ndërfaqetare në Shqipëri, duke qenë asnjnjës në çështjet e besimit dhe duke njohur barazinë e bashkësive fetare dhe respektuar pavarësinë e tyre;
- Shprehjen e mendimit të tij Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, lidhur me planin mësimor, programet dhe tekstet e pjesës jolaike, për kërkesat e paraqitura për hapjen e institucioneve arsimore jopublike, institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare dhe në bashkëpunim me atë institucion, në varësi të ndarjes administrative territoriale, të interesave të përbashkëta ekonomike dhe të traditës historike e fetare;
- Interesimin për ruajtjen e vlerave të objekteve të kultit në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe me komunitetet fetare;
- Paraqitjen e mendimit të tij Ministrisë së Financave, lidhur me hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të mallrave me karakter fetar për komunitetet fetare dhe për përjashtimin e tyre nga taksa doganore, në përputhje me ligjet në fuqi;
- Vendorsjen dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet homologe të vendeve të tjera e të diasporës, në funksion të promovimit të bashkëjetesës fetare në vend.

Organizimi i KSHK

Në bazë të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 229, datë 15.12.2023 “Për miratimin e organikës së Komitetit Shtetëror për Kultet”, organika e Institutcionit përbëhet nga: 1 Kryetar, 5 Anëtarë, 3 Specialistë dhe një shofer.

ORGANIGRAMA:



Përveç detyrave të paraqitura në organigramën e mësipërme, Kryetari i KSHK bën ndarje detyrash sipas përgjegjësi dhe nevojave institucionale, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Titullari, edhe gjatë vitit 2024, ka qenë përgjegjës për ndjekjen e plotësimit të objektivave specifike për secilin punonjës dhe ka bërë vlerësimin e performancës për ta, gjatë gjithë harkut kohor të vitit 2024. Ky proces i nështrohet legjislacionit në fuqi për administratën publike dhe menaxhimin e kontrollin financiar në njësitë qendrore publike.

Struktura e thjeshtë organike krijon kushtet për një kontroll të brendshëm efikas dhe të vazhdueshëm, gjë që ndikon pozitivisht në ritmet e punës së KSHK dhe në mungesën e humbjeve kohore që mund të shkaktoheshin nga burokracia brenda institucionit.

KAPITULLI II

Drejtimet kryesore për realizimin e objektivave gjatë vitit 2024

Komiteti Shtetëror për Kultet funksionon në zbatim të VKM-së nr. 459, datë 23.09.1999, i ndryshuar me VKM nr. 128, datë 11.03.2004. Pika 1, që shprehimisht thotë: “...*krijimin e KSHK për të ndihmuar në krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve ndërmjet*

shtetit dhe bashkësive fetare, që kanë objekt dhe ndjekin qëllime besimi dhe ndërgjegje, sipas ligjit në Republikën e Shqipërisë ...”, çka përcakton rolin kryesor të tij.

KSHK, edhe gjatë vitit 2024, ka vijuar të kryejë rolin bashkërendues të tij, mes shtetit dhe organizmave fetarë. Kjo është realizuar duke u udhëhequr nga parimet e ligjit themeltar të shtetit, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që me nenet 10 dhe 24 garanton të drejtën e lirisë së fesë e besimit, si dhe të legjislacionit në fuqi mbi fenë dhe organizmat fetarë.

Komiteti Shtetëror për Kultet, si çdo institucion i administratës shtetërore, përcakton objektiva afatmesëm e afatshkurtër, për përmbushjen e misionit të tij. Këto objektiva reflektohen dhe dokumentohen në Programin Buxhetor Afatmesëm, në Planin Vjetor të Punës dhe në planet specifike të punonjësve, të cilat përpilohen nga vetë Titullari.

➤ **Kalendari i aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2024**

Në bazë të veprimtarisë së tij, Komiteti Shtetëror për Kultet ka kryer një sërë aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit të parashikuara gjatë vitit 2024.

1. Në mënyrë periodike e të vazhdueshme, Anëtarët dhe Kryetari i KSHK kanë zhvilluar takime të rëndësishme me përfaqësues e drejtues të komuniteteve fetare dhe të pushtetit vendor, me organizma qendrore/lokale të interesuara për promovimin e harmonisë fetare shqiptare, kanë kryer një sërë vizitash në objektet fetare me statusin monument kulture, në të gjitha qytetet kryesore të vendit dhe rrethinat e tij, si në Korçë, Gjirokastrë, Përmet, Fier, Tropojë, Berat, Peshkopi, Has, Skrapar, Malësi e Madhe, Kukës, Shkodër, etj, si dhe kanë marrë pjesë në pelegrinazhe të ndryshme në gjithë vendin.

Gjithashtu, kanë ndjekur një sërë aktiviteteve, konferencash, seminaresh e simpoziumesh shkencore të organizuara prej tyre në vend, si:

- Fronëzimi i Mitropolitit të Beratit, Vlorës dhe Kaninës, Hirësi Astit, në Katedralen e Shën Dhimitrit, në Berat, më 21.11.2024. Shërbesa e fronëzimit u kryesua nga Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe Gjithë Shqipërisë, Imzot Anastasi, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Sinodit të Shenjtë, klerikëve të shumtë nga të gjitha mitropolitë, përfaqësuesve të pushtetit lokal, personaliteteve, përfaqësuesve të komuniteteve fetare lokale dhe qindra besimtarëve shpresëtarë nga i gjithë vendi.
- Zgjedhja e Kryepiskopit Anastas si Kreu i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë për vitin 2024, në mbledhjen e parë të të cilit morën pjesë liderët e komuniteteve fetare, anëtarë të Bordit të Presidencës: H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë; Fortlumturia e Tij Anastasi, Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë; Mons. Angelo Massafra, President i Konferencës Ipeshkvnore; H. Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve; Pastor Ergest Biti, Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.

- 114-vjetori i lindjes dhe 27-vjetorin e vdekjes së Nënë Terezës, në kuadër të manifestimit tradicional kulturor dhe shkencor “Drita e Gonxhes”, ku, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, në bashkëpunim me Arqidioqezën Metropolitane Tiranë-Durrës dhe Shtëpinë Botuese Drita, Kosovë, organizoi promovimin e disa librave, në sallën “Kardinal Ernest Troshani” në Tiranë.
- Organizimi i Forumit Ndërkombëtar me pjesëmarrjen e Këshillave Ndërfetarë të Evropës, nga Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, zhvilluar në Tiranë.
- Përrurimi i qendrës së re kulturore të Famullisë “Zemra e Krishtit”, me ftesë të Atë Zef Bishës, epror i jezuitëve në Tiranë, ku morën pjesë shumë personalitete të Kishës Katolike, eprori i lartë i “Shoqërisë së Jezusit”, Atë Arturo Sosa, si dhe përfaqësues të të gjitha komuniteteve fetare në vendin tonë, ambasadorë të vendeve të huaja, etj.
- Përkujtimi i poetit të madh mbarëkombëtar, Naim Frashëri, përmes ritit vjetor të Selisë së Shenjtë bektashiane.
- Mesha solemne dhe Riti i kanonizimit të Atë Luigj Paliq dhe Don Gjon Gazulli, në Katedralen e Shën Shtjefnit në Shkodër, me ftesë të Arqipeshkvit Metropolit Shkodër-Pult, imzot Angelo Massafra, në prani të të dërguarit të posaçëm të Atit të Shenjtë, Papa Françeskut, Eminenca e Tij Kard. Marcello Semeraro, Prefekt i Dikasterit për Çështjet e Shenjtërve, ku të pranishëm ishin edhe Ipeshkvijtë e Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë dhe Italisë, Kardinali shqiptar, Eminenca e Tij Kard. Ernest Troshani Simoni, si dhe autoritete civile e fetare.
- Konferenca shkencore me temë: “Masakra ndaj teqeve, klerikëve dhe besimtarëve bektashianë, në vitet 1913 – 1914”, nën kujdesin e Kryegjyshit Botëror, Haxhi Dede Baba, Edmond Brahimaj.
- Takimi i Med 24 “Shtegtarë të shpresës, ndërtues të paqes”, në Tiranë, nën kujdesin e Sh.T Imzot Arjan Dodaj, në kuadër të 10-vjetorit të vizitës së Papa Françeskut në vendin tonë, me pjesëmarrjen e 50 të rinjve, nga 25 vende të ndryshme të detit Mesdhe dhe të Detit të Vdekur, me përkatësi të ndryshme fetare.
- Konferenca VI Kombëtare për të Drejtën e Informimit: “Ndërtimi i besimit: Promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit”, organizuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA).
- Në 100-vjetorin e ngritjes së Medresesë së Tiranës, si një nga institucionet më të vjetra e të rëndësishme arsimore në Shqipëri.
- Përkujtimi i 9-vjetorit të përrurimit të Odeonit, qendrës fetare-kulturore në Selinë e Shenjtë bektashiane.
- Inaugurimi i Xhamisë së Namazgjasë, në prani të Kryeministrit të Shqipërisë, Z. Edi Rama dhe Presidentit të Turqisë, R. T. Erdogan, me pjesëmarrjen e klerikëve myslimanë,

krerëve e përfaqësuesve të besimeve të tjera fetare, drejtues të institucioneve shtetërore, besimtarë e dashmimirës të shumtë.

- Ceremoniali tradicional i pelegrinazhit në Malin e Shenjtë të Tomorrit, me pjesëmarrjen e qindra besimtarëve.
- Aktiviteti artistiko-fetar me temë: “Gruaja, arkitektja e shoqërisë”, organizuar nga Zyra e Gruas pranë Komitetit Mysliman të Shqipërisë.
- Takime të Kryetarit të Komitetit Shtetëror për Kultet dhe Anëtarëve, me Krerët lokalë fetarë;
- Takime të Kryetarit të Komitetit Shtetëror për Kultet dhe Anëtarëve, me përfaqësues të pushtetit vendor;
- Vizita të Kryetarit të Komitetit Shtetëror për Kultet dhe Anëtarëve, nëpër shkollat e bashkësive fetare, si dhe në objektet fetare me status monument kulture (KMSH, KOASH, KKSH, KBB, VUSH); etj.

2. Janë zhvilluar takime të rëndësishme me organizmat ndërkombëtarë që trajtojnë çështje të të drejtave të njeriut dhe të lirisë së besimit e fesë. Në kuadër të raportimit dhe promovimit të vlerave të harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare në arenën ndërkombëtare, veçojmë pjesëmarrjen e KSHK në Sesionin 55-të të Këshillit për të Drejtat e Njeriut, në Gjenevë, Zvicër, në panelin e diskutimit mbi luftën ndaj urrejtjes fetare, si nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë, në të cilin u identifikuan shkaqet thelbësore që sjellin përdhosjen e librave të shenjtë, vendeve të adhurimit dhe simboleve fetare, si dhe u evidentuan hapësirat ligjore, politikat dhe praktikat që duhet të parandalojnë këto akte të paramenduara publike.

Në raportet vjetore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në kapitujt e lirisë së fesë, çmohet mbështetja e qeverisë në drejtim të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, si dhe roli i KSHK, nën autoritetin e Kryeministrit, si bashkërendues i marrëdhënieve mes qeverisë dhe të gjitha organizmave me karakter fetar.

➤ **Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe ato lokale**

Komiteti Shtetëror për Kultet ka vijuar bashkëpunimin me institucionet qendrore, duke dhënë mendimet dhe kontributin e tij, ku ndër më kryesoret kanë qenë:

- Në përgatitjen e deritanishme të Shqipërisë për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, mbi Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2024: kontributi i KSHK në përgatitjen e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, si pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, si dhe në përgatitjen e Udhërrëfyesit për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike.

- Në procesin e punës së Komisionit të përbashkët *ad-hoc*, me Urdhër të Kryeministrit Nr. 142, datë 01.08.2024, “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Pjesëmarrjen në Komisionin e Përbashkët *Ad-Hoc* për Zgjidhjen e Çështjes së Trajtimit të Pronave (kthimit dhe kompensimit) të Kishës Katolike në Republikën e Shqipërisë”, ku gjatë periudhës shtator-dhjetor 2024, janë zhvilluar disa takime mbi kërkesat e Kishës Katolike në Shqipëri, të cilat u janë paraqitur institucioneve si: Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për problematikat e pronësisë të pretenduara.
- Procesi i përfundimit të regjistrimit të pronës së paluajtshme të zyrave të Komitetit Shtetëror për Kultet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit Nr. 13, datë 05.07.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për organizimin dhe ndjekjen e procesit të evidentimit dhe regjistrimit të pronave të paluajtshme shtetërore, në përgjegjësi administrimi të Kryeministrit”, proces i cili u kurorëzua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2024 “Për një shtesë në Vendimin Nr. 339, datë 01.06.2004 të Këshillit të Ministrave, “Për sistemimin në mjedise pune të disa institucioneve shtetërore dhe për një ndryshim në Vendimin Nr. 515, datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes””, të ndryshuar.

➤ Nevoja për përmirësim

Në zbatim të detyrës së tij ligjore të shprehur në pikën 2/2 dhe 2/5 të VKM-së nr. 459, datë 23.09.1999, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet”, shprehimisht: “*Negocion për përgatitjen e marrëveshjeve ndërmjet përfaqësuesve të bashkësive fetare dhe Këshillit të Ministrave*” dhe “*Bashkëpunon me bashkësitë fetare për përgatitjen e projektligjeve dhe akteve nënligjore, që kanë të bëjnë me kultet fetare*”, Komiteti Shtetëror për Kultet ka vijuar angazhimin institucional në këtë drejtim. Marrëveshjet e nënshkuara mes Këshillit të Ministrave dhe bashkësive fetare i përkasin një periudhe të para disa viteve, ku nevojat e kohës ishin të tjera krahasuar me të sotmet. Përveç kësaj, duke qënë se disa aspekte juridiko-fiskale të këtyre marrëveshjeve paraqesin paqartësi në zbatim nga institucionet shtetërore, rishikimi bëhet i domosdoshëm. Duke qënë se janë palë në këtë marrëveshje, janë zhvilluar takime konsultuese me bashkësitë fetare. Në këto takime është mbledhur informacion mbi kërkesat/propozimet e bashkësive fetare, për të cilat do të adresohen në institucionet e linjës.

Çështje e rëndësishme që kërkon zgjidhje dhe vijon të diskutohet është dhe çështja e kthimit të pronave që u përkasin bashkësive fetare, të sekuestruara nga shteti gjatë regjimit komunist.

KAPITULLI III

Buxheti për vitin 2024

Komiteti Shtetëror për Kultet është një institucion qendror dhe si i tillë, i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për administratën publike. Duke qenë një institucion buxhetor dhe duke përfituar fonde nga buxheti i shtetit, ai harton politikat e tij në linjë me politikat qeveritare mbi fenë, duke i alokuar fondet përkatëse për realizimin e objektivave të parashikuara.

Për këtë qëllim dhe në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022, “Për Buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, dhe të Udhëzimit plotësues Nr. 2, datë 19.1.2024, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, të gjithë komponentët e PBA 2024-2026 janë hartuar që të harmonizojnë politikat/objektivat e Komitetit Shtetëror për Kultet, me shpërndarjen buxhetore për realizimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 10140, datë 15.05.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, gjatë vitit 2024 janë shqyrtuar kërkesat e paraqitura prej bashkësive fetare. Shuma e akorduar nga Këshilli i Ministrave ishte në masën prej 113 000 000 lekësh, e shpërndarë sipas VKM-së nr. 266, datë 02.05.2024 “Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e shtetit 2024, për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”.

➤ Zërat ekonomikë dhe realizimi i tyre

Në zbatim të politikës së programit “Mbështetje për Kultet Fetare” si një mjet për garantimin e një mjedisi ku, çdo bashkësi fetare të shprehë dhe të praktikojë lirisht të drejtën kushtetuese të besimit dhe duke iu përmbajtur tavaneve buxhetore të miratuara me VKM-në nr. 535, datë 12.08.2024 “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”, është bërë shpërndarja e fondeve buxhetore sipas artikujve ekonomikë, për secilin produkt.

Përdorimi i fondeve buxhetore e detyron institucionin të zbatojë me përpikmëri ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, duke monitoruar vazhdimisht gjatë harkut vjetor, përputhshmërinë e shpenzimeve institucionale me shkallën e realizimit të objektivave. Në plotësimin e objektivave të pasqyruara në PBA-në e sipërpërmendur, duke përdorur me efikasitet dhe eficiencë burimet financiare dhe njerëzore, Grupi i Menaxhimit Strategjik, ka ndjekur hap pas hapi, ecurinë e realizimit të objektivave dhe përdorimin e fondeve përkatëse të destinuar për

to, duke dhënë rekomandimet e rastit, duke korrigjuar dhe rialokuar fondet dhe duke ndërhyrë, në rast mangësish, për të realizuar arritjen e objektivave.

Akordimi i fondit buxhetor bën të mundur realizimin e objektivave. Buxheti fillestar për vitin 2024 ka qenë në total në vlerën 142,921,000 lekë, ndërsa buxheti i rishikuar është 143,041,500 lekë. Gjatë 4-mujorit të dytë, fondi i KSHK-së është rritur me 120,500 lekë për mbulimin e shpenzimeve të personelit (paga + sigurime shoqërore), në zbatim të VKM-së nr. 421 datë 26.06.2024 “Për disa ndryshime në VKM-në nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, si dhe VKM-së 422, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në VKM-së nr. 326, datë 31.05.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar. Në dhjetor të vitit 2024, në zbatim të VKM-së nr. 846, datë 26.12.2024 “Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore”, në artikullin 606 u akordua një shtesë fondi në vlerën 5000 lekë.

Fondet e akorduara me ndryshimet gjatë vitit 2024, për funksionimin e aktivitetit të KSHK-së janë në total në vlerën 143,047 (në mijë lekë), me paraqitjen strukturore të mëposhtme:

Tabela e buxhetit të miratuar sipas zërave ekonomikë për vitin 2024

Art.	EMËRTIMI	BUXHETI VJETOR (Plani fillestar i vitit 2024) (në 000/lekë)	BUXHETI VJETOR (Plani përfundimtar viti 2024) (në 000/lekë)
600	Paga	16,461	16,567
601	Sigurime shoqërore	2685	2700
602	Mallra e shërbime të tjera	9,575	9575
604	Transferta Korente të Brendshme	113,000	113,000
230-231	Llog 231 Investime	1,000	1,000


606	Fondi i vecantë	200	205
Totali		142,921	143,047

Tabela e shpërndarjes sipas zërave ekonomikë për vitin 2024.

SHPENZIME PERSONELI (Lekë)	PLANI VJETOR (Mijë Lekë)	REALIZIMI VJETOR (Mijë Lekë)	PËRQINDJA (%)
Zëri ekonomik 600 (PAGAT)	16,567	16,367	99.%
Zëri ekonomik 601 (SIGURIMET SHËND. dhe SHOQ.)	2,700	2,671	99%
Zëri ekonomik 602 (MALLRA dhe SHËRBIME)	9,575	3832	40%
Zëri ekonomik 604 (TRANSFERTA me të TRETË)	113,000	113,000	100%
Zëri ekonomik 606 (Transferta tek individë)	205	204	99%
Zëri ekonomik 231 (INVESTIME)	1000	405	40%
Totali	143,047	136,479	95%

- Në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 229, datë 15.12.2023 “Për miratimin e organikës së Komitetit Shtetëror për Kultet”, me 10 punonjës faktik, realizimi i zërave për pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është bërë në masën 99% të fondit të planifikuar për vitin 2024.
- Fondi për shpenzimet operative është realizuar në masën 40% të fondit të planifikuar për vitin 2024. Ky fond është realizuar për shërbime ndaj të tretëve, si për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, shërbime bankare, postare e telefonike shërbime pastrimi, shpenzime transporti, si furnizim me karburant, mirëmbajtje automjeti, goma dhe bateri, siguracion automjeti, lavazhi, shpenzime udhëtimit, për udhëtime brenda vendit të punonjësve, si dhe shpenzime për shërbime të tjera mirëmbajtjeje të zakonshme, etj.
- Një nga pjesët kryesore të buxhetit e përbën zëri për transfertat korrente të brendshme, i cili është realizuar në masën 100%, pas miratimit të VKM-së “Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e shtetit 2024, për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”.
- Fondi për investime për këtë vit është realizuar në masën 40%, për zërin “Blerje mobilje zyre”, në vlerën 88,200 lekë, dhe “Blerje pajisje elektrike dhe elektronike”, në vlerën 316,944. Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planifikuar për vitin 2024, KSHK ka shpenzuar 138,118,221 lekë. Është realizuar buxheti në tërësi në masën 95% kundrejt planit vjetor të vitit 2024.

Grafiku i realizimit të zërave ekonomike për vitet 2023/2024



Grafiku krahasues i realizimit në (%) për vitet 2024/2024




Tabela e realizimeve të prokurimeve 2024

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës së Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik
1	Bileta të transportit ajror ndërkombëtar	800,000	Purchase Tickets	88,500	23/02/2024 11:10 AM	SPIRIT TRAVEL & TOURS	L32403002P
2	Blerje kancelarie	100,000		99,517		ONIS	K01312004V
3	Blerje karburanti	1,000,000	Small Value	278,333	08/11/2024 10:00 AM	"GEGA CENTER GKG"	K66801001T
				301,666	22/05/2024 01:30 PM	"GEGA CENTER GKG"	K66801001T
4	Blerje orendi zyre	166,666	Small Value	73,500	10/05/2024 09:30 AM	ANORIA	J61824069Ë
5	Blerje pajisje elektrike	666,666	Small Value	220,120	17/12/2024 10:45 AM	CRF	M21307517P
				44,000	17/12/2024 11:30 AM	Erjon Haska	M02123033S
6	Blerje tonerash për printer dhe fotokopje	100,000		97,073		InfoSoft Office	J62426002Q
7	Materiale pastrimi	100,000		41,642		Pastrime Silvio	K91413010N
8	Mbushje e fikseve të zjarrit e shërbime të tjera	100,000		7,200		Vjollca Logu	L71406037B
9	Riparim automjeti	63,250		63,250		Vol-AI Service	K91313048D
10	Riparim defekti të automjetit	33,333		33,333		Vol-AI Service	K91313048D
11	Riparim dhe mirëmbajtje e automjetit të institucionit	375,000	Small Value	13,000	19/11/2024 01:30 PM	TRONIX	L71821024L
				90,000	01/10/2024 02:45 PM	Erblina Beqiri	M22421024U

12	Shërbime larje mjet transporti	75,000		13,200		VIKTOR KOLA	M01722017B
				13,800			
				13,800			
				13,800			
13	Shërbime mirëmbajtje pajisje zyre	100,000		1,672		Host.AL	L82309007S
				35,000		KURA-CORP	M32204051T
14	Shërbime mirëmbajtje (periodike) të automjetit	100,000		20,999		Vol-AI Service	K91313048D
15	Shërbime pastrimi për zyra	208,333	Small Value	169,000	09/01/2024 01:30 PM	AIR	L51712008C
16	Shërbime printimi	100,000		28,000		ERMIR PETANAJ	K71616042A
17	Shërbime pritje përcjellje	100,000		9,600		BAR RESTAURANT PIAZZA	K72211001V
18	Sigurimi i mjetit të transportit	100,000		28,162		SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP sh.a.	J91329003O

KONKLUSIONE

Viti 2024 ka shënuar vazhdimësinë e misionit institucional të Komitetit Shtetëror për Kultet. Objektivat janë realizuar në nivel të kënaqshëm.

Aktivitetet/takimet e ndërmarra nga institucioni për të rritur ndjeshmërinë ndaj problemeve sociale dhe për të forcuar bashkëpunimin shtet-fe në nivel kombëtar, janë bërë dhe duhet të vazhdojnë të bëhen shtysë për shtim vëmendjeje dhe përmirësim komunikimi nga ana e KSHK.

Efiçienca institucionale duhet forcuar nëpërmjet rritjes së iniciativës në ndërmarrjen e veprimeve që përmbliohen në mision ligjor të tij, në thellimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera qendrore dhe vendore dhe në zgjerimin e promovimit ndërkombëtar të harmonisë fetare në vend.